



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 114/2013
Prishtinë, më 16.07.2013, në orën 10:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla S–II

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha–Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Ethem Arifi.

Munguan: Fikrim Damka dhe Visar Ymeri.

Pjesëmarrës të tjerë: Ahmet Krasniqi, Gani Asllani dhe Haliti Shabani - AKK; Ukë Gashi - ZPRK; Burim Ejupi – INDEP; Donjetë Hoxha - BIRN – gazetarë; Fehmi Preva – Kuvendi Kosovës; Qëndresa Mrasori – praktikante.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 02.07.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime i Projektligjit Nr. 04/L-198 për tregtinë e mallrave strategjike;
4. Funksimi i Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës – AKK;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës dhe, njëherit i dëshiroj mirëseardhje anëtarit të ri të Komisionit z.Etem Arifi nga Grupi Parlamentar SLS, i cili është në vend të deputetes z.Biserka Kostiq.

1. Miratimi i rendit të ditës

Myzejene Selmani – Propozoj që Raporti i Qeverisë për Privatizimin e PTK-së të procedohet tutje dhe Kryesia e Kuvendit ta radhit për debat në mbledhje plenare të Kuvendit, sepse s’kemi me çka e mbajmë në Komision këtë Raport.

Kryetari - Tha se pasi që është mbajtur dëgjimi publik për këtë çështje, unë do t’ia dërgojë një shkresë Kryesisë së Kuvendit dhe do ta njoftojë më krejt procesin dhe pastaj është e Kryesisë të vendosë a të futet në rend dite në seancë, apo na e kthen përsëri neve si Komision.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 02.07.2013

Procesverbalet nga dy mbledhjet e mbajtura më 02.07.2013 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime i Projektligjit Nr. 04/L-198 për tregtinë e mallrave strategjike

Kryetari – Tha se pas shqyrtimit edhe nga komisionet e përhershme të Raportit me amendamente për Projektligjin Nr. 04/L-198 për tregtinë e mallrave strategjike, nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje, dhe sipas Rregullores së Kuvendit, duhet të procedohet për seancë plenare.

Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me rekomandime i Projektligjit Nr. 04/L-198 për tregtinë e mallrave strategjike.*
- 2. Raporti t’i procedohet Kuvendit, sipas procedurës për lexim të dytë.*

4. Funksionimi i Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës – AKK

Kryetari – Theksoi se ashtu siç është paraparë, në këtë pikë të rendit të ditës, do të diskutojmë rreth funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës, pasi që kohëve të fundit, kemi pasur disa kërkesa nga dy anëtarë të Bordit për mos funksionim të mirë të bordit të AAK-së. Ne kemi ftuar tre anëtarët e Bordit të AKK-së, së pari z. Ahmet Krasniqi, në cilësinë e ushtruesit të detyrës së kryetarit të Bordit të AKK, i cili do të paraqesë një prezantim të shkurtër për mënyrën se si po funksionon ky Autoritet dhe pastaj edhe dy anëtarët e Bordit, z. Gani Asllani dhe z. Halit Shabani që mund ta marrin fjalën dhe, pastaj deputetet do të mund të diskutojnë dhe të shtrojnë pyetje për Bordin.

Ahmet Krasniqi, ushtrues detyre i kryetarit të Bordit të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës (AKK) – Paraqiti në vija të përgjithshme funksionimin e AKK-së duke dhënë sqarime edhe për kërkesat e dy anëtarëve të Bordit. Ai tha se deri sa ka qenë kryetari Osman Ejupi në Bord, unë kam qenë nënkryetar i Bordit dhe mandej më përfundimin e mandatit të kryetarit të

Bordit, e kam marrë mandatin si UD i kryetarit të Bordit, sepse kam qenë nënkryetar dhe vendimin për këtë e kam nxjerrë vetë. Ai tha se asnjëherë nuk jam kontestuar si UD i kryetarit të Bordit por kur kohëve të fundit kam filluar të marrë masa rreth uljes së shpenzimeve të Autoritetit si për kafe, mbushje të telefonave, përdorimin e veturave etj, atëherë me anëtarët e Bordit kam filluar që të kemi probleme. Zoti Krasniqi akuzoi z. Halit Shabani edhe z. Gani Asllani, pra dy anëtarët e Bordit se kanë bërë komplot dhe së bashku me sekretarin e Autoritetit janë duke e penguar funksionin e AKK, sepse nuk përgjigjen në mbledhje të Bordit, shantazhojnë më pjesën tjetër të stafit dhe po ashtu edhe sekretari nuk i zbaton urdhrat e tij. Ai tha se e kam suspenduar sekretarin pasi që nuk i ka zbatuar urdhrat edhe pas disa problemeve ose kacafytjeve personale që kemi pasur. Dhe, njëherit tha se ai nuk është duke e respektuar vendimin për suspendim dhe përsëri vjen në punë kur njëherit bën presion në staf tjetër i cili u bën thirrje për moszbatim të urdhrave, duke mos më njohur si UD i kryetarit të Bordit të AKK. Në fund tha se sa i përket ankesave të dy anëtarëve të Bordit ato nuk qëndrojnë dhe janë të pavërteta dhe shtoj se Autoriteti nuk është duke funksionuar për shkak të këtyre problemeve.

Gani Asllani, anëtar i Bordit të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës (AKK) – Në fillim kërkoi falje për nivelin në të cilin ka ra ky Autoritet dhe nivelin e ulët të debatit. Ai paraqiti pretendimet e tij në lidhje më sjelljet e UD të Bordit, z. Krasniqi, ku ndër të tjera tha se edhe pas takimit më kryetarin e Komisionit, z. Pajaziti dhe rekomandimeve të tij për të vazhduar punën, njoftoi se përsëri zoti Krasniqi nuk e përfill askënd dhe vepron në kokën e vet dhe në emër të tij për Autoritetin duke vepruar kështu në kundërshtim me ligj. Sepse siç dihet Bordi, ose Komisioni i Konkurrencës është organ kolegjal dhe vendimet merren më shumicë votash. Ai tha se nuk ka asgjë personale ndaj askujt dhe shtoj se edhe pse deri më tani 95% të punëve i ka kryer vet duke marrë parasysh përgatitjen profesionale, prapë shprehu gatishmërinë të japë kontributin e tij dhe të funksionalizohet AKK, që sipas tij është jashtë funksionit.

Halit Shabani, anëtar i Bordit të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës (AKK) – Që në fillim tha se nuk qëndrojnë asnjë nga dëshmitë e UD të kryetarit z. Krasniqi. Ai qëndroi pranë deklaratave të tij të proceduara më shkrim duke shtuar së Ligji për mbrojtjen e konkurrencës shumë qartë e përcakton se vendimet merren më shumicë votash dhe këtë e përforcon edhe shkresa me interpretimin e ligjit nga Komisioni për Legjislacion. Në fund, ai tha se UD, zoti Krasniqi, e ka shndërruar AKK si pronë të veten dhe madje e mban vulën e Autoritetit në xhep dhe nuk pyet askënd për asgjë dhe se fundi e ka suspenduar sekretarin në kundërshtim me ligjin. Në fund kërkoi që sa më shpejt të zgjidhet kjo çështje dhe të vihet në funksion Autoriteti.

Ramiz Kelmendi – Tha se në rastin e nxjerrës së rekomandimeve duhet të këtë kujdes dhe të ruaj reputacionin e këtij Autoriteti, sepse është një agjenci shumë e rëndësishme dhe normale se aty dikush mundohet të vendosë rregulla mund të këtë pakënaqësi nga palët e tjera, por askush nuk mundet që të shfrytëzojë pozitën dhe të nxjerrë vendime arbitrare.

Shaip Muja – Tha se siç po shihet ky Autoritet nuk është duke funksionuar dhe kërkoj që sa më shpejt të gjendet zgjidhje. Ai propozoi që dy anëtarët e Bordit z. Gani Asllani dhe z. Halit Shabani të shkarkohen, sepse janë të angazhuar në vend tjetër të punës, nëpër kolegje private dhe njëherit duhet të njoftohet Qeveria që t'i propozojë anëtarët e rinj dhe të kompletohet Komisioni i Konkurrencës me Bord të ri.

Myzejene Selmani – Tha se ndihet keq për nivelin e të tre anëtarëve të Bordit dhe i vjen keq që në mandatin e kaluar ka propozuar që të emërohen si anëtar të Bordit. Sepse është e papranueshme që për shkak të raporteve personale të mos funksionojë Autoriteti i Konkurrencës dhe ne, si shtet, të marrim vërejtje nga Brukseli.

Lutfi Zharku – Tha se në bazë të kësaj gjendje mund të konstatojmë që Autoriteti i Konkurrencës nuk është funksional dhe ne, si Komision, duhet të marrim masa për të përmirësuar gjendjen. Ai propozoi që Komisioni në bazë të rekomandimeve të veta të konfirmojë që kryesues i Bordit është z. Ahmet Krasniqi, për shkak se duhet të kemi komunikim; të sjellën urgjentisht propozimet nga Qeveria për dy anëtarët që mungojnë; duhet të rishikohet Statuti dhe të qartësohen kompetencat në lidhje me çështjet administrative etj.

Sala Berisha – Shala – Tha se po shihen qartë problemet që janë në këtë Bord dhe duhet të marrim masa sa më shpejt ta ndryshojmë gjendjen. Ajo tha se nuk mund të ndryshojmë Statutin, sepse disa çështje janë të qarta në Ligj dhe kemi nenin 25 të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ku thuhet se Komisioni i Konkurrencës është organ kolegjal, po ashtu kemi edhe nenin 27 i cili thotë se vetëm më propozim të Qeverisë mund të shkarkohen. Ajo vuri ne pah se ka shkelje të ligjit, sepse dy anëtarët e Bordit janë në marrëdhënie pune në kolegje private ku japin mësim që bie ndesh me nenin 26, paragrafi 3.1. dhe i bëri thirrje Komisionit që sa më shpejt të nxjerrë rekomandimet në lidhje me këtë Autoritet.

Hashim Deshishku – Tha së asnjëri nga të tretë nuk janë në nivel të detyrës për të cilën janë emëruar dhe kërkoj që Komisioni të nxjerrë një vendim për shkarkimin e tyre dhe të propozohen sipas ligjit anëtarë të rinj për këtë Bord.

Kryetari – Tha së në bazë të debatit kemi konstatuar së Autoriteti i Konkurrencës nuk është duke funksionuar dhe madje e kanë shkel ligjin, respektivisht nenin 28, paragrafi 2, të cilët më sjelljet e tyre janë duke e dëmtuar rëndë reputacionin e AKK-së. Në bazë të kësaj kemi disa propozime si në vijim: të shkarkohet Bordi; të konfirmohet si kryesues i Bordit z. Ahmet Krasniqi deri në zgjidhjen e kryetarit të ri për shkak të komunikimit; të sjellën urgjentisht propozimet nga Qeveria për Bordin e ri; duhet të rishikohet Statuti i AKK; dhe të zhvendosën nga hapësirat e Kuvendit dhe të gjejnë lokacion më të mirë për punë.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Në mbledhjen e radhës të nxirën Rekomandimet në bazë të debatit të sotëm.

5. Te ndryshme Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit,

Zenun Pajaziti